



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1877/2 prot.

Puke, me 22.10.2024

V E N D I M

Nr. 47 datë 16.10.2024

“PËR MIRATIMIN E KERKESËS SË BASHKISË PUKË, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR FAMILJEN E Z. ARDIAN KECI, BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA RENIE ZJARRI(DJEGIE) , NGA FONDI I KUSHTËZUAR I BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE DHE FONDI EMERGJENCIVE CIVILE , BUXHETI I BASHKISE PUKË”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”i ndryshuar. neni 29, neni 54 shkronja “dh”, neni 55 pika 3, neni 64 shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, të VKM Nr. 329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare për mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore” kreu III VKM nr 414 date date 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile” Shkreses nr. 446/2 Prot date 20.02.2024 “ Mbi fondin e Kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile, të **Vendimi i Keshillit Bashkiak Puke nr. 47 date 29.12. 2023 “Per miratimin e PBA 2024-2026 dhe buxhetin e vitit 2024”**, me propozim te Kryetarit te Bashkise ,Keshilli i Bashkise Puke, pasi mori ne shqyrtim dokumentacionin tekniko- ligjor, diskutoi dhe në perfundim :


V E N D O S I:

1. Te miratoje kerkesen e Bashkise Puke për mbeshtetje financiare per familjen e shtetasit Ardian Keci , per demtimin e baneses se tij nga renie zjarri (djegie) .
2. Ti akordoje familjes se shtetasit Ardian Keci ndihmen e financiare në vleren totale: 1.251.868.5 lekë.
3. Të miratojë vleren në masën 800.000 leke nga fondi i kushtezuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile me kod produkti- 91707AB- “Shtetas te ndihmuar banesat e te cileve jane demtuar nga fatkeqesi te ndryshme” .
4. Të miratojë vleren në masen 451868.5 lekë nga buxheti për emergjencat civile i Bashkisë Pukë i vitit 2024, duke pakësuar fonfin rezervë në vkb nr 47 datë 29.12.2023, kapitull 01, Program 04910, llogari ekonomike 60900000fondi emergjencave.
5. Ndhima financiare për familjen e shtetasit Ardian Keci , përcaktohet sipas VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
6. Vlera e plotë e dëmit sipas vlerësimit te grupit të punës së Bashkisë Pukë është:1.805.257.08lekë

7. Vlera e plote e demit nga ana ndërtimore është : 1.106.777.08 lekë dhe 50% e vleres ne masen 553.388.5 leke akordohet per ndihme financiare.
8. Vlera e plote e demit ne paisje dhe oriendi eshte ne masen 698.480 leke dhe akordohet ne masen 100% te vleres per ndihme finaciar.
9. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finaces, Sektori i Emergjencave Civile
10. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 te ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “ Per vetqeverisjen vendore”
11. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.
Vota te vlefshme gjithsej 12
Vota pro 12, vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni



KRYETARI

Gjon GJOKA





04.11.24

2024/11/04/11/24



1877/3

04.11.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 730/1 prot.

Shkodër, më 01.11.2024

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 47, datë 16.10.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, pika 1, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "gj", neni 41, pika 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, të shkresës së Këshillit Bashkiak Pukë nr. 1896/3 prot., datë 22.10.2024 "Dërgojmë Vendimet e Këshillit Bashkiak Pukë të datës 16.10.2024", të datës 02.07.2024", shqyrtoi VKB Pukë nr. 47, datë 16.10.2024 "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë, për akordimin e ndihmës së menjehershme financiare, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për familjen e z. Ardian Keci, Fshati Mesul, NJAD Gjegjan, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënie zjarri sipas "Vërtetim për rënie zjarri" të MZSH të datës 27.09.2024, nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe nga fondi i emergjencave civile nga buxheti i Bashkisë Pukë", me vlere totale të dëmeve ndërtimore dhe në orendi 1 988 063,5 lekë. Gjatë trajtimit, konstatohet se nuk është zbatuar shkronja "ç" e pikës 3, Kreu III e VKM Nr.329/2012, e cila shprehet se masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale (banesa dhe orendi) do të jetë 50% e vlerës së llogaritur, ndërkohë sipas pikës 8 të vendimit Tuaj është akorduar vlere e dëmit në orendi dhe paisje në masën 100%. Për sa trajtuar, Prefekti nuk ju autorizon procedim të mëtejshëm, por keni detyrimin e korigjimit të vendimarrjes në mbledhjen më të afët të këshillit. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Matilda KONGONI